



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLOGOC

Numri i lëndës: 2022:196427

Datë: 27.12.2023

Numri i dokumentit: 05127978

PPP. nr. 148/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLOGOC Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.Sh nga Komuna e Glllogocit të cilin e përfaqëson H.H.1 nga Glllogoci, kundër debitorit F.N nga Komuna e Glllogocit, lidhur me borxhin në vlerë prej 600.00 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit privat H.H.2, P.nr... i datës 15.04.2019, jashtë seancës me datë 27.12.2023 e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorëve F.N, nga komuna e Glllogocit, kundër urdhërit të Përmbaruesit Privat P.nr... i datës 15.04.2019, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit K.Sh nga komuna e Glllogocit, për përmbarimin e borxhit në shumën prej 600.00 € në bazë të titullit të përmbarueshëm-Aktgjykimit C.nr... i datës 18.10.2010, ndërsa urdhëri i Përmbaruesit Privat H.H.2 , P.nr... i datës 15.04.2019 **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

Kreditori K.Sh nga Komuna e Glllogocit ka parashtruar Propozim tek Përmbaruesi Privat H.H.2 nga Glllogoci, për lejimin e përmbarimit në bazë të Dokumentit Përmbarueshëm – Aktgjykimit C.nr.107/2009 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc i datës 28.10.2010 që përmban vulën katrore të formës së prerë të datës 29.10.2014 dhe vulën e ekzekutueshmërisë të datës 16.12.2014, lidhur me pagesën e borxhit kryesor në emër të shpenzimeve gjyqësore kontestimore në lartësi prej 600.00 €, me kamatë vjetore si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor, në të kundërtën të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë dokumentit të përmbarueshëm të Aktgjykimit me shenjën C.nr.107/2009 i datës 18.10.2010 i formës së prerë me datën 29.10.2014 dhe i ekzekutueshëm nga data 16.12.2014.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit në afatin ligjor, me arsyetimin se, Aktgjykim me të cilën kërkohet përmbarimi është parashkruar e drejta e kërkimit të borxhit pasi që vendimi është marr me datën 18.10.2010, dhe se nuk janë përmbaruar elementet e dokumentit të përmbarueshëm, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 par. 1 të LPP-së të aprovohet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbarim i përmbaruesit privat.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke e kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe Urdhëri P.nr... të datës 15.04.2019 të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pa i bazuar, ndërsa kundërshtimet e prapësimit të dhëna nga kreditori në përgjigje në prapësim, gjykata i konsideroi si të qëndrueshme dhe atë për këto arsye.

Me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka bërë për përmbarimin e dokumentit të përmbarueshëm – Aktgjykimit C.nr.107/2009 i datës 10.10.2010 të lartëcekur për shkak të detyrimit në të holla nga pika II e aktgjykimit, i cili propozim është lejuar me urdhërin e Përmbaruesit Privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbarimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga Aktgjykimi si në rastin konkret.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarimi, se çka përmban dokumenti i përmbarimit, se çka duhet të përmbarë një propozim për përmbarim të dokumentit të besueshëm, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit në bazë të ekstrakteve, faturave janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të Nenit 21, 22, 29, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentet të përmbarueshëm nga i cili shihet se debitori i ka borxhin në fjalë kreditorit.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj Kreditorit pasi që pretendon se Aktgjykim me të cilën kërkohet përmbarimi është i parashkruar e drejta e kërkesës për borxhin në fjalë, dhe se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhëri përmbarues nuk ka titull ekzekutiv. Gjykata nuk e aprovoj këtë pretendim të debitorit pasi që Aktgjykimi është bërë i formës së prerë nga data 29.10.2014 dhe ka titull ekzekutiv/i ekzekutueshëm me datën 16.12.2014.

Neni 361 par. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) përcakton se *“Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për 10 vite, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim.* Kreditori, në anën tjetër propozimit për përmbarim i ka bashkangjitur dokumentin e formës së prerë që nga data 29.10.2014 dhe i përmbarueshëm që nga data 16.12.2014 në rastin konkret Aktgjykimin C.nr.107/2009 i datës 18.10.2010, ndërsa propozimi për përmbarim është paraqitur me datën 30.04.2019 - pas 4 vjet e 6 muaj nga data 29.10.2014 si datë e formës së prerë të aktgjykimit, si dhe pas 8 vjet e gjashtë muaj e 12 ditë e gjysmë nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit me datën 18.10.2010. Andaj, aktgjykimi i lartëcekur i plotëson kushtet ligjore për të u trajtuar dokument i përmbarueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të Nenit 22 dhe 24 të LPP-së, dhe i afatshëm në kuptim të Nenit 361 par. 1 të LMD-së.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhërin përmbarues për caktimin e përmbarimit P.nr... të datës 15.04.2019, duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Gllgoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 148/19, datë 27.12.2023**

**Gj y q t a r i
Astrit Gashi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.